

Në bazë të nenit 174 paragrafit dy pikëz 5 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta zyrtare e Malit të Zi" numër 2/18 034/19 ), neni 53 paragrafit 1 pikëz dy të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e Malit të Zi" – Dispozitat komunale numër 24/19) Kuvendi i Komunës së Tuzit në seancën e mbajtur më 05.11.2019, ka sjellë

## **VENDIM**

### **mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare**

#### **I DISPOZITAT THELBESORE**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim përcaktohen kriteret, mënyra dhe procedura e shpërndarjes së mjeteve të Buxhetit të Komunës së Tuzit të parapara për përkrahjen e projekteve dhe programeve të organizatave joqeveritare.

Me vendim parashihet edhe forma e projektit si dhe përmbajtja e fletëparaqitjes për paraqitjen në konkurs.

##### **Neni 2**

Shprehjet të cilat përdoren në këtë Vendim për personat fizik të gjinisë mashkullore, të njëjtat nënkuptohen edhe për gjininë femërore.

#### **II PERDORUESIT E MJETEVE**

##### **Neni 3**

Mjetet e buxhetit në shumën prej 0.5% deri në 1.0% të buxhetit për vitin rrjedhës ju ndahen organizatave joqeveritare të cilat janë të reregjistruara në Mal të Zi, me seli në Komunën e Tuzit (në tekstin e mëtejmen: Komuna), për projekte të cilat në tërësi realizohen në territorin e Komunës.

##### **Neni 4**

#### **Organizatave joqeveritare me status të veçantë**

Mjetet nga buxheti i shpërndahen organizatave joqeveritare të cilat për komunën kanë status të veçantë në mënyrën se për këto organizata joqeveritare parashihen 20% nga tërësia të mjeteve të parapara për financimin e projekteve të organizatave joqeveritare.

Për shkak të rëndësisë së veçantë të Komunës, vazhdimësisë në punë, mbi afirmimin dhe ruajtjen e traditës, kulturës dhe trashëgimisë historike, përkujdesja e njohjes dhe ruajtjes së identitetit të trashëgimisë, zhvillimit të humanizmit dhe mbrojtjes së personave me nevoja të posaçme, status të veçantë kanë organizatat joqeveritare: "Fëmijët e Malit të Zi" dhe "Koret".

Organizatave joqeveritare nga paragrafi 2 i këtij neni nuk paraqiten në konkursin publik, por dorëzojnë programin vjetor të aktiviteteve, paravendosjes së projekt buxhetit të komunës në shqyrtim publik.

Këto organizata joqeveritare raportin përshkruar vjetor dhe financiar mbi mjetet e fituara me ndarje, i dorëzojnë deri në fund të vitit rrjedhës për të cilin janë ndarë mjetet.

Përderisa organizatat joqeveritare me status të veçantë nuk dorëzojnë raportet e kërkuara nga paragrafi 4 i këtij neni në afatin e paraparë ose në raport nuk dorëzon arsyetimin detajor të devijimeve eventuale, Komisioni mund të vendosi që nuk mund të shfrytëzojnë mjetet e parapara me buxhet për vitin e ardhshëm.

Mjetet e pa shpërndara sipas vendimit të komisionit kalohen në fondin e mjeteve të parapara për financimin e organizatave joqeveritare të tjera.

Shuma e mjeteve të parapara për organizatat joqeveritare me status të veçantë përben pjesën përbërëse të mjeteve të përgjithshme të parapara për financimin e projekteve të

organizatave joqeveritare për vitin e caktuar buxhetore me ç' rast është i shënuar në mënyrë të veçantë.

Komisioni miraton mjetet për organizatat jo qeveritare me status të veçantë për aktivitetet nga programi vjetorë e të cilat paraqesin aktivitete me rëndësi për ngritjen e kualitetit të punës gjegjësisht të shërbimit të organizatës joqeveritare me qëllim të pjesëmarrjen kualitative në programet me rëndësi për Komunën.

### **III PERCAKTIMI I PRIORITEVE PËR SHPERNDARJEN E MJETEVE**

#### **Neni 5**

Mjetet e planifikuara me Buxhetin e Komunës shpërndahen për përkrahjen e projekteve dhe programeve të organizatave joqeveritare të cilët kontribuojnë në realizimin e qëllimeve të caktuara sipas dokumenteve strategjike, programeve dhe planeve të komunës, përmes të cilave veçanërisht:

- Sigurohet larmia, kualiteti i shërbimit në fushën sociale, shëndetësore të mbrojtës së fëmijëve dhe rinisë me pengesa në zhvillim, personave me invaliditet, barazisë gjinore dhe formave të tjera të mbrojtës:

- Afirmojnë mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe të pakicave,
- Afirmojnë potenciale kulturore, të traditave dhe veçorive kulturore të Komunës, të iniciativës dhe aktivitetit në qëllim të ngritjes së nivelit të kulturës urbane dhe ruajtës së trashëgimisë mesdhetare,
- Kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit jetësorë dhe zhvillimit të qëndrueshëm,
- Arrijnë zhvillim ekonomik të komunës,
- Lufta kundër korrupsionit,
- Në mënyra të ndryshme afirmojnë participimin e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe ngrenë nivelin e demokratizimit të shoqërisë në vetëqeverisje lokale.

Komisioni pas konsultimeve me Këshillin për bashkëpunim të vetëqeverisjes lokale dhe organizatave joqeveritare dhe organeve të administratës lokale të cilët implementojnë dokumente strategjike, plane dhe programe me rëndësi për Komunën, propozimi i fushave prioritare çon në pëlqim drejt kryetarit të komunës, përderisa janë të formuara.

Në bazë të propozimit të unifikuar nga paragrafi 2 i këtij neni kryetari i komunës përcakton fushat prioritare me interes publik për vitin e ardhshëm si dhe lartësinë e mjeteve për financimin e projekteve dhe programeve të organizatave jo qeveritare, para miratimit të Buxhetit për vitin e ardhshëm.

Komisioni për çdo vit, në pajtim me fushat e caktuara prioritare gjatë shpalljes së konkursit publik, do të shpallin numrin dhe llojin e prioriteve.

Projektet të cilët nuk do të përkrahën janë:

- Projekti për të cilin nga burimet të tjera është miratuar financimi i plotë i tij,
- Aktivitetet të cilat janë në kompetencat ose përgjegjësitë e Qeverisë, siç është arsimiti formal, mbrojtja formale shëndetësore dhe ngjashëm,
- Projekti me të cilin kërkohen mjete financiare për blerjen dhe ndarjen e ndihmave humanitare,
- Projekti i cili veçanërisht bazohet në hartim të njëhershëm, përgatitjen dhe shtypjen e librave, broshurave, buletineve, revistave, përveç nëse publikimi i tyre është pjesë e ndonjë programi të gjere apo gjithëpërfshirës i aktiviteteve të vazhdueshme të cilët janë me rëndësi për komunën,
- Projekti qëllimi i të cilit është arritja e nevojave personale të anëtarëve të organizatës,
- Projekti i cili përjashtimisht ka qëllim profitin gjegjësisht lëmire komerciale.

## **IV KOMISIONI PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE**

### **Neni 6**

Shpërndarjen e mjeteve e bën: Komisioni për shpërndarjen e mjeteve të organizatave joqeveritare në tekstin e mëtejshëm: (Komisioni) të cilin e cakton kryetari i Komunës.

Komisioni ka kryetarin dhe dy anëtarë.

Kryetari i komisionit është nga rrallët e epërore të organeve të administratës lokale.

Anëtarët e komisionit janë një anëtarë nga rrallët e zyrtareve lokal dhe një anëtarë përfaqësues i organizatave joqeveritare i cili zgjidhet përmes ftesës zyrtare.

Anëtari i komisionit nga rrallët e organizatave joqeveritare nuk mund të jetë këshilltarë deputet ose anëtar i organit drejtues të partive politike, funksionarë publik, zyrtarë apo nëpunës lokal apo shtetërore, udhëheqës ose i punësuar në institucionet publike dhe shoqëritë afariste themelues i të cilave është shteti ose komuna.

Mandati i komisionit është 2 vjeçare.

Anëtari i komisionit nga rrallët e organizatave joqeveritare nuk mund të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi paraqitjen në konkursin publik të cilin e ka dorëzuar organizata joqeveritare, e cila e ka propozuar për përfaqësues të OJQ-ve në Komision. Nëse OJQ-të nuk propozojnë kandidatin e tyre për anëtarë të Komisionit për anëtar të dytë të komisionit caktohet përfaqësuesi i komunës.

Punët profesionale administrativo-teknike për nevojat e Komisionit i kryen Sekretari i Komisionit i cili caktohet nga Sekretariati për vetëqeverisje lokale.

Komisioni sjell Rregulloren mbi punën e Komisionit.

## **V ZGJEDHJA E PERFAQESUESVE TË ORGANIZATAVE JO QEVERTARE NE KOMISION**

### **Neni 7**

Anëtarin e Komisionit nga rrallët e organizatave joqeveritare e propozojnë organizatat joqeveritare të cilat janë të reregjistruara në Mal të Zi selia e të cilave është në Mal të Zi.

procedura për propozimin e kandidateve të Komisionit, përfaqësuesve të organizatave joqeveritare fillohet me publikim të ftesës zyrtare nga ana e Kryetarit të Komunës.

Ftesa zyrtare publikohet në portalin e Komunës në tabelën informative të Komunës, përmes emetuesve lokal publik dhe në mënyra të tjera të arritshme.

Ftesa zyrtare përmban kushtet të cilat duhet të plotësojë organizatat joqeveritare për propozimin e kandidateve, kushtet të cilat duhet të plotësojë kandidati, dokumentacioni i cili dorëzohet bashkë me propozimin e kandidatit, si dhe afatin dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit afati për propozimin e kandidateve është 8 ditë nga dita e publikimit të ftesës publike.

Procedurën e zgjedhjes e udhëheq organi i administratës lokale kompetent për bashkëpunimin me OJQ-të.

### **Neni 8**

Kandidatin për anëtar të Komisionit mund ta propozojë organizata joqeveritare e cila plotëson kushtet në vijim:

- Të jete e regjistruar në regjistrin e OJQ-ve, së paku një vit para publikimit të ftesës publike,
- Të ketë selinë në territorin e Komunës së Tuzit ;
- Të ketë realizuar një apo më shumë projekte në periudhën e mëparshme, çka dëshmon përmes kontratës mbi financimin, broshura dhe ngjashëm;
- Që më shumë se gjysma e organit udhëheqës të organizatës joqeveritare mos të jenë anëtar të organeve të partive politike, funksionar lokal, udhëheqës ose të

punësuar në institucionet publike dhe shoqëritë afariste themelues i të cilave është shteti ose Komuna, gjë të cilën e fakton përmes deklaratës.

#### **Neni 9**

Kandidati i OJQ-së për anëtare të komisionit mund të jete personi i cili:

- Është nënshkruar Malazet dhe ka vendqëndrimin në territorin e komunës së Tuzit,
- Ka përvojë në hartimin dhe realizimin e projekteve,
- Nuk është anëtarë i organeve të partive politike, funksionare publik, zyrtare ose nëpunës shtetërorë ose lokal, udhëheqës ose i punësuar në institucion publik ose shoqëri afariste themelues i të cilave është shteti ose komuna.

#### **Neni 10**

Organizata joqeveritare e cila propozon kandidatin për anëtar të Komisionit, krahas dokumentacionit nga neni 8 i këtij vendimi është e obliguar që për kandidatin të dorëzojë edhe :

- Biografin e kandidatit me të dhënat mbi posedimin e përvojës në hartimin dhe realizimin e projekteve ;
- Deklaratën e kandidatit që nuk është anëtar i organeve të partive politike, funksionar publik, zyrtar apo nëpunës shtetëror apo lokal, udhëheqës apo i punësuar në institucion publik apo shoqëri afariste themelues i të cilës është shteti apo komuna ;
- Deklaratën e kandidatit për pranimin e kandidaturës për anëtar të Komisionit.

#### **Neni 11**

Përderisa organizata joqeveritare ose kandidati i propozuar nuk i plotësojnë kushtet e parapara me këtë vendim apo kërkesa për kandidatin nuk është dorëzuar brenda afatit të paraparë, këto propozime nuk do të shqyrtohen.

#### **Neni 12**

Grupi punues të cilin e cakton kryetari i Komunës është i obliguar që në afat prej 7 ditësh nga skadimi i afatit për dorëzimin e propozimit, të publikojnë portalin e Komunës, listën e caktuar të kandidatëve.

Nëse janë propozuar më shumë kandidat , kryetari i Komunës do të caktoj kandidatin e organizatës joqeveritare i cili është propozuar nga numri më i madh i organizatave joqeveritare të cilat kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë.

Në rast se secila organizatë joqeveritare propozon kandidat të ndryshëm , kryetari i Komunës do të caktoj kandidatin më shumë përvojë në hartimin dhe realizimin e projekteve.

### **VI NDERPRERJA E MANDATIT TË ANËTAREVE TË KOMISIONIT**

#### **Neni 13**

Anëtarit të komisionit i nder prehet mandati, para skadimit të kohës në të cilën është emëruar, në rast :

- Dhënies së dorëheqjes për çka lajmëron kryetarin e Komisionit dhe subjektet të cilat e kanë propozuar;
- Nëse me vendim juridik është ndaluar të kryej aktivitete të punës ;
- Nëse me vendim juridik është gjyqur me burg të pakushtëzuar për periudhën kohore më së paku gjashtë muaj;
- Në rast shkarkimi.

#### **Neni 14**

Kryetari i Komunës do ta shkarkoj anëtarin e Komisionit në rast se:

- Se vërtetohet se gjatë emërimit ka dhënë të dhëna të pasakta për veten ose ka bërë lëshime në dhënien e të dhënave dhe rrethanave të cilat kanë qenë me ndikim në emërimin për anëtar të komisionit ;
- Nuk kryen e funksionin e anëtarit të komisionit në periudhën më të gjatë se 30 ditë ;  
ka ardhur deri te ndryshimi i ndonjë rrethane nga neni 9 paragrafi 1 pika 3 e këtij Vendimi.

#### **Neni 15**

Procesi për shkarkimin e anëtarit të Komisionit inicohet nga kryetari i Komunës në kërkesë të subjektit të autorizuar për propozimin e kandidatëve ose në iniciative të Komisionit.

Në procedurën për shkarkim anëtari i Komisionit ka të drejtë që të sqarohet mbi arsyet për shkarkim.

Kryetari i Komunës sjellë vendimin për shkarkimin e anëtarit të Komisionit.

#### **Neni 16**

Në rast të ndërprerjes së mandatit të anëtarit të komisionit , para skadimit të kohës në të cilin është emëruar , kryetari i Komunës është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e ndërprerjes së mandatit, të publikoj ftesën zyrtare për propozimin e kandidatit të ri.

Mandati i anëtarit të riemëruar të komisionit zgjatë deri në skadimin e mandatit të komisionit. Anëtari i komisionit i cili është shkarkuar para skadimit të kohës në të cilën është emëruar , nuk mund të jetë i zgjedhur përsëri për anëtar të komisionit.

### **VII KONKURSI PUBLIK**

#### **Neni 17**

Shpërndarja e mjeteve për projektet e organizatave joqeveritare bëhet në bazë të konkursit publik ( në taksin e mëtejme : Konkurs), të cilin e publikon Komisioni për shpërndarjen e mjeteve për organizatat joqeveritare në kuartalin e parë të vitit rrjedhës.

Në rast se mjetet e parapara nuk shpërndahen ose nuk shpërndahen në tërësi, shpallet konkursi i ri, me të njëjtat prioritet, më së largu deri në përfundimin e vitit për të cilin janë të parapara mjetet.

#### **Neni 18**

Konkursi shpallet në portalin e Komunës në tabelën e shpalljeve të Komunës, pranë emetuesit publik lokal dhe në mënyra të tjera përkatëse.

Lajmërimi mbi konkursin shpallet në një media të shkrimit.

Organizatave joqeveritare me status të veçante nuk marrin pjesë në konkurs në pajtim me paragrafin 3 nenin 4 të këtij vendimi.

### **VII PROCEDURA SIPAS KONKURSIT**

#### **1. Paraqitja në Konkurs**

#### **Neni 19**

Organizata joqeveritare dorëzon fletëparaqitjen në Konkurs , në afat prej 30 ditësh nga dita e shpalljes së tij, në formën e paraparë dhe me dokumentacionin e nevojshëm.

Fletëparaqitja dorëzohet pran Komisionit në zarfe të vulosur dhe dorëzohet në zyrën për çështjet kancelarike – zyra e gjendjes civile e Komunës.

Krahas fletëparaqitjes dorëzohet:

- Aktvendimin mbi regjistrimin në regjistrin e organizatave joqeveritare me seli në Komunën e Tuzit;
- Projektin me të cilin organizata konkurrin për ndarjen e mjeteve;
- Raportin mbi projektet e realizuara për vitin paraprak, përfunduar me ditën e shpalljes së konkursit;

- Të dhënat mbi përvojën e të punësuarve , gjegjësisht vullnetareve në organizatën joqeveritare në punë të ngjashme ;
- Propozimet e eksperteve nga fushat relevante – nëse i posedoni ;
- deklaratën se organizata joqeveritare projektin e kandiduar e ka ose nuk e ka dorëzuar tek ndonjë donator tjetër në shqyrtim në periudhën e mëparshme ose në kohën e dorëzimit në konkurs të Komunës;
- Deklarata e personit të autorizuar se nuk janë fituar mjete të tjera nga donator të tjerë për projektin ose një pjesë të projektit i cili kandidohet dhe e cila përmban rregulloren për pranimin e përgjegjësisë;
- versioni i printuar dhe elektronik i projektit në CD.

#### **Neni 20**

Organizata joqeveritare të cilës janë ndarë mjetet sipas Konkursit për vitin paraprak dorëzon:

- Raportin mbi realizimin e projektit, me përshkrim të detajuar të fazave të realizimit dhe me arsyetim të detajuar të ndryshimeve eventuale;
- Raportin financiar mbi mjetet e shpenzuara për vitin paraprak me kopjet e llogarisë, kontratës ,certifikatës bankare sipas secilës janë paguar
- Raport përshkruar në formë tabelare të shpenzimeve për mjetet e shpenzuara.

OJQ- ja është e obliguar që 30 ditë pas afatit për realizimin e projektit ti dorëzoj komisionit raportet e larte shënuara.

Përderisa OJQ-ja nuk dorëzon raportet e kërkuara nga paragrafi 1 i këtij neni ose në raport nuk shënon arsyetimin e detajuar të ndryshimeve eventuale , nuk mund të marrim pjesë në shpërndarjen e mjeteve për vitin në të cilin ndahen mjetet.

Me kontratë do të precizohen se cilat janë obligimet e organizatave joqeveritare sipas raportit mbi mjetet e shpenzuara.

#### **Neni 21**

Organizata joqeveritare mund të konkurroj për shumën totale ose një pjesë të mjeteve për realizimin e aktiviteteve nga projekti dhe është e obliguar që këtë ta theksoj.

### **2. Përmbajta e projektit**

#### **Neni 22**

Projekti duhet të përmbaj :

- Emrin e projektit;
- Emërtimin e organizatës joqeveritare (selinë, telefonin-faks-e- mail, numrin e të punësuarve, qëllimet e organizatës);
- Kategorinë – fushën prioritare të projektit ;
- Qëllimet e projektit (në cilën mënyrë kontribuuan projekti në zgjedhjen e problemeve);
- Përshkrimi i problemit ;
- Përshkrimi i grupit qëllimor ;
- Afati për realizimin e projektit;
- Përshkrimi i lidhjes së projektit me politikat publike ( strategjitë , planet aksionare, aktet ligjore dhe nënligjore) në fushën e cekur të cilën e ka sjellë Komuna ose shteti;
- Përshkrimin detajor të projektit ( të përshkruhet sipas segmenteve dhe sipas mundësisë të kuantifikohen të gjitha aktivitetet e projektit dhe dinamika e realizimit të projektit), se bashku me dokumentacionin përcjellës eventual të nevojshëm ( skica, plane , vizatime, fotografi , simulime kompjuterike, prezantim në CD dhe ngjashëm) ;

- Buxheti i projektit dhe shuma e mjeteve për të cilat konkurrohet , shuma e mjeteve personale si dhe shuma e mjeteve të cilat për të njëjtin program janë miratuar nga ana e donatoreve të tjetre nëse ka këso mjetesh të miratuara ;
- Mënyra e përcjellje dhe përlllogaritjes së suksesit të realizimit të projektit;
- Qëndrueshmëria e projektit ;
- Përshkrim i shkurt i projekteve të realizuara në vitin paraprak ;
- Përshkrim i shkurtër i organizatës partnere dhe projekteve të realizuara në vitin paraprak (nëse ka);
- Personi i autorizuar( përgjegjës) për realizimin e projektit (emri dhe mbiemri, adresa , telefoni, e-mail );
- Të dhënat mbi anëtarët e organeve drejtuese të organizatës ;
- Numri i xhirollogarisë dhe NIT i organizatës .

### **Përmbajtja e fletëparaqitjes në Konkurs**

#### **Neni 23**

Me qëllim të arritjes së kushteve të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit e konkursit, si dhe procedurës metodologjike, me të cilën Komisioni do të kryej selektimin e drejtë të projekteve të organizatave joqeveritare në Konkurs, përshkruhet një formë për paraqitjen e projektit.

#### **Neni 24**

Paraqitja në konkurs përbëhet prej tre pjesëve.

Pjesa e parë e formularit plotësohet nga ana e zyrtarit të shërbimit në byronë për punët zyrtare, zyrës së gjendjes civile dhe përmban:

- Kreun e Komunës;
- Emrin e Komisionit;
- Emrin e formularit;
- Vitin për të cilin shpallët konkursi;
- Numrin e protokollit përcjellës të Komunës;
- Datën me të cilën është regjistruar projekti i OJQ-s në byronë për punë zyrtare – zyrës së gjendjes civile të Komunës;
- Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar të të punësuarit të byrosë për punë zyrtare – zyrës së gjendjes civile i cili e ka pranuar projektin.

Pjesa e dytë e formularit plotësohet nga ana e personit të autorizuar nga organizata joqeveritare dhe përmban:

- Emrin e organizatës joqeveritare;
- Të dhënat për regjistrimin e organizatës joqeveritare;
- Të dhënat për personat e angazhuar (në marrëdhënie pune, të angazhuar sipas kontratës së punës dhe ngjashëm);
- Fusha në të cilën vepron;
- Data e regjistrimit në regjistrin e organizatave joqeveritare të cilin e udhëheqë organi i administratës lokale;
- Selinë e organizatës;
- Rubrika TE TJERA me të cilën shënohen informacionet shtesë mbi projektin të cilat janë me rëndësi për vendimmarrjen të Komisionit, të cilat në vende të tjera nuk janë përmendur,
- Shënimin se për korrektësinë e të dhënave të paraqitura përgjigj personi i autorizuar nga ana e organizatës joqeveritare për plotësimin e fletëparaqitjes.

Pjesa e 3-të e formularit plotësohet nga Komisioni gjatë vendimmarrjes dhe përmban:

- Shenja se përkrah projektin në tërësi ose shenjen se përkrahet një pjesë e projektit,
- Emrin e sakte të projektit,

- Notën e projektit në numra ( ne bazë te shkallës se notimit sipas kritereve te përcaktuara ne këtë Vendim ), te cilin e plotëson komisioni pas përfundimit te vlerësimit te projektit,
- Shenjen se projekti refuzohet ose programi plotësohet ne rast se nuk është i plotësuar rubrika nga paragrafi 1,
- Rubrikën me arsyetimin detajor për refuzim (plotësohet ne rast te refuzimit),
- Rubrikën TE TJERA për mendime shtesë dhe arsyeime lidhur me projektin me rëndësi për vendimmarrje.

Komisionet, e vlerësimi i tyre nuk është i parapare me kriteret e parapara.

- Nënshkrimet e kryetarit te Komisionit dhe te gjithë anëtarët e komisionit veçanërisht.

#### **4. Verifikimi administrativ**

##### **Neni 25**

Komisioni hap brenda kohës zarfet e vulosura te dorëzuara, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e skadimit te afatit për dorëzimin e kërkesave.

Nëse organizata joqeveritare ka dorëzuar dokumentacion te paplotë ose te pa kuptueshëm Komisioni menjëherë e më se voni me afat prej 3 ditësh prej kohës se hapjes se zarfit do te kërkojë nga ana e organizatës joqeveritare se te plotësoje dokumentacionin.

Afati për plotësimin te dokumentacionit është 5 dite nga dita e dorëzimit te lajmërimit.

Nëse organizata joqeveritare nuk bën plotësimin e mangësive brenda afatit të lartpërmendur Komisioni do ta refuzoje kërkesën.

#### **5. Kriteret për shpërndarje**

##### **Neni 26**

Shuma maksimale i mjeteve te shpërndara për një organizate joqeveritare e cila e kandidon projektin nuk mund te kalojë shumën e 20% të shumës se përgjithshme te buxhetit Komunal të paraparë për organizatat joqeveritare, kur kemi te bëjmë kur përjashtohen organizatat joqeveritare me status te veçantë.

Shuma minimale e mjeteve qe do ti ndahet organizatës joqeveritare nëse projekti i saj do te miratohet nga ana e Komisionit, sipas rregullit nuk mund te jete ma e vogël se 80% e shumes se kërkuar për financimin e atij projekti.

Nëse projekti i organizatës joqeveritare nuk mund te jete i financuar ne shumen e mjeteve qe është shënuar ne fletë paraqitje Komisioni do te kërkojë nga ana e organizatës joqeveritare sqarime ne forme te shkruar mbi atë se nëse me më pak mjete te ndara a do te mund ta realizonin projektin gjegjësisht programin.

Projekti nga paragrafi 3 i këtij neni do te financohet nëse organizata joqeveritare sqaron se me më pak mjete te ndara mund ta bëje realizimin e atij projekti.

Sqarimi nga paragrafi 3 i këtij neni i organizatës joqeveritare i dorëzohet komisionit ne fat prej 5 ditësh.

##### **Neni 27**

Shpërndarja e mjeteve për projektin behet ne baze te kritereve ne vijim:

- 1) Kontributi i projektit te paraqitur ne realizimin e interesit publik dhe realizimin e qëllimeve strategjike ne fushën e caktuar,
- 2) Cilësia e projektit te paraqitur,
- 3) Kapaciteti i OJQ-së për realizimin e projektit te paraqitur,
- 4) Transparenca e punës së OJQ-së



### **Neni 28**

Për vlersimin e projekteve për nga kriteret e nenit 27 të këtij vendimi përdoret skala nga 0 deri në 10 pikë për çdo kriter në veçanti. Çdo anëtarë i Komisionit i ndan bodat për çdo kriter.

Vlersimi përfundimtar i projektit është shuma e pikëve të të gjithë anëtarëve të komisionit të ndarë me numrin e anëtarëve të komisionit (vlersimi mesatar i projektit).

### **6. përcaktimi i ranglistës**

#### **Neni 29**

Në baze të numrit të pikëve që janë notuar komisioni përcakton ranglistën. Gjatë vendimmarrjes mbi shpërndarjen e mjeteve për financimin e projekteve nuk do të merret në shqyrtim projekti nga ranglista nga paragrafi 1 i këtij neni:

- Te cilët janë notuar me numrin e pikëve nën 50% e pikëve të parapara nga kriteri nenit 27 të këtij Vendimi,
- Te cilët janë në baze të kriterit të notimit nga neni 27 paragrafi 1 pika 1 e këtij Vendimi, janë notuar me piket nën 50% e pikëve maksimale të parapara për atë kriter.

### **7. Vendimi për shpërndarjen e mjeteve**

#### **Neni 30**

Komisioni nga neni 6 i këtij vendimi sjell Vendimin mbi shpërndarjen e mjeteve. Organizatës joqeveritare e cila në konkurs ka paraqit më shumë projekte, mund ti ndahen mjete për financim të vetëm një projekti.

Në rast se dy apo më shumë projekte fitojnë të njëjtat pikë, e mjetet e parapara nuk janë të mjaftueshme për financimin e tyre mjetet do ti ndahen projektit i cili sipas vlerësimit të shumicës së numrit të anëtarëve të komisionit i cili më me sukses kënaq apo ndihmon në realizimin e njëjës prej nevojave prioritare të qytetareve.

#### **Neni 31**

Komisioni është i obliguar që të sjellë vendimin mbi shpërndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të konkursit.

#### **Neni 32**

Vendimi mbi shpërndarjen e mjeteve përmban:

- Emrin e organizatave të cilat u janë shpërndarë mjetet;
- Të dhënat e personave përgjegjës për secilën prej organizatës të cilës u janë shpërndarë mjetet;
- Emri i projektit;
- Kohëzgjatja e projektit;
- Shuma e mjeteve të shpërndara nga ana e komisionit për secilin projekt;
- Shuma e përgjithshme e mjeteve të nevojshme për realizimin e secilit projekt me të dhënat e donatoreve të tjera eventuale;
- Arsyesimi i arsyes se refuzimit, përfshirë listën e pikëve, për të gjitha projektet e refuzuara.

#### **Neni 33**

Vendimi mbi shpërndarjen e mjeteve ju dorëzohet pjesëmarrësve të konkursit në afat prej 8 ditësh nga dita e sjellës, publikohen në portalin e Komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës, përmes emetuesit lokal publik dhe në mënyrë të tjetër të përshtatshme.

Në vendim mund të paraqitet ankesa drejtuar kryeadministratorit.

## **IX LIDHJA E KONTRATËS**

### **Neni 34**

Kryetari i komunës lidh kontratë me organizatën joqeveritare me të cilin rregullohen të drejtat e ndërsjella dhe detyrimet, mënyra e shfrytëzimit të mjeteve, raportimi dhe mbikëqyrja e realizimit të projektit me afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të Vendimit.

### **Neni 35**

Në internet portalin e komunës publikohen projektet komplete për të cilat janë ndarë mjetet si dhe kontratat me organizatat joqeveritare.

## **X PERCIEDHJA E REALIZIMIT TE PROJEKTEVE**

### **Neni 36**

Përcjelljen e realizimit të projekteve e bën Komisioni në pajtim me aktin e paraparë të veçantë.

## **XI RAPORTI MBI PROJEKTIN E REALIZUAR**

### **Neni 37**

Organizatave joqeveritare të cilat u janë shpërndarë mjetet për projekte i dorëzojnë Komisionit raportin mbi realizimin e projektit me raportin financiar, në afatin nga neni 20 paragrafi 2 i këtij Vendimi.

### **Neni 38**

Me qëllim të informimit të publikut të gjerë me projektet e realizuara komisioni do të prezantojë aktivitetet e realizuara të organizatave projektet e të cilave janë përkrahur, në mënyrë të përshtatshme, deri në shpalljen e konkursit tjetër.

### **Neni 39**

Komisioni i dorëzon kuvendit të komunës raport mbi shumën e mjeteve të shpërndara, projektet e realizuara dhe efektet e tyre.

Raporti dorëzohet në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm për vitin e kaluar.

### **Neni 40**

Komisionit i takon kompensimi për punë. Lartësinë e kompensimit e përcakton kryetari i komunës në pajtim me aktin e veçantë, duke u nisur nga puna të cilën e ka kryer komisioni.

## **XII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE**

### **Neni 41**

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi përfundon se vlejtori vendimi mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare ("Fleta zyrtare e Malit të Zi, dispozitat komunale", numër 013/18 prej më 20.04.2018).

### **Neni 42**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Fletën zyrtare të Malit të Zi – Dispozitat komunale".

Nr: 02-030/19-7423

Tuz, 05.11.2019

**KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT**

**KRYETARI,**

**Fadil Kajoshaj**